



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

2094/1
Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 08/04/2021

URDHËR

Nr. 307 datë 08/04/2021

**“PËR HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT,
NOTERIT ARBEN HAVERI”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 26, pika 2, gërma “dh”, të nenit 53, pika 2, gërma “b” të ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, si dhe Vendimit të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë nr.2/2021, datë 23.03.2021,

KONSTATOJ:

Me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.29, datë 27.01.2021, pas shkeljeve të konstatuara, është vendosur nisja e procedimit disiplinor për noterin Arben Haveri, i cili është dërguar me dokumentacionin respektiv pranë Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Nga analiza e rrethanave dhe fakteve të konstatuara si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve ligjore sipas Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.350, datë 24.06.2019, rezulton si rrjedhojë e mos respektimit të detyrimeve që burojnë nga Ligji nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar. Gjithashtu, nga ana e noterit nuk është përmbushur detyrimi për përcjelljen e dokumentacionit të rifreksuar si noter, sipas Urdhrit nr.214, datë 21.03.2019, “Për përcaktimin e listës së dokumenteve për rifreskimin e dosjes së plotë personale të noterëve dhe asistent noterëve”.

Në vijim, pranë Ministrisë së Drejtësisë është administruar Vendimi i Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë protokolluar me nr.599/8 Prot., datë 26.03.2021.

Nga ana e Bordit Disiplinor është konstatuar se:

Noteri nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për përmbushjen e detyrave që janë lënë në bazë të Urdhërit të Ministrisë së Drejtësisë me nr.350 Prot., datë 24.06.2019. Konkretisht në përmbushje të detyrimeve ligjore që lidhen me ushtrimin e detyrës së noterit, noteri Arben Haveri, dëshmon një qendrim totalisht të painteresuar për të njohur, kuptuar dhe zbatuar detyrimet ligjore që lidhen me:

- Hedhjen e akteve dhe të dhënave në sistemin RNSH;

Përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga Ligji nr.9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar dhe kërkesat e DPPPP për vënien në dispozicion të çdo informacioni apo dokumenti të kërkuar nga DPPPP;

- *Zbatimin e legjislacionit në fushën e noterisë.*

Më tej, noteri nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për rivendosjen në vend të shkeljeve që janë konstatuar nga Raporti i Grupit të Kontrollit dhe nga Urdhëri i Ministrit të Drejtësisë me nr.350 prot., datë 24.06.2019. Edhe gjatë seancës dëgjimore, noteri nuk provoi se mban regjistrin e përgjithshëm të akteve dhe veprimeve noteriale, të nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë dhe për të siguruar shërbimin publik në interes të klientëve. Duke mos pasur arkivën e nevojshme dhe pajisjet e sigurta ose kasafortat për mbajtjen e dokumentacionit arkivor, noteri cënon rëndë funksionet e profesionit që ushtron.

Në lidhje me natyrën e shkeljeve, Bordi Disiplinor ka konkluduar se shkeljet e konstatuara nga Raporti i Grupit të Kontrollit, që kanë çuar Ministrinë e Drejtësisë në nxjerrjen e Urdhërit nr.350 Prot., datë 24.06.2019, përbëjnë shkelje të rënda. Në kuptim të nenit 26, të Ligjit nr.110/2018 "Për noterinë", sipas të cilit masa disiplinore e dhënë ndaj një noteri jepet në proporcion me shkeljen dhe bazohet në kriteret e mëposhtme:

- a) shkallën e pakujdesisë;*
- b) shpeshtësinë e kryerjes së gabimit;*
- c) probabilitetin dhe rëndesën e dëmit të mundshëm nga shkelja;*
- ç) çdo situatë që është jashtë kontrollit të noterit dhe që mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme.*

Gjithashtu, vërehet se noteri me dashje nuk ka përmbushur detyrimet ligjore dhe as urdhërimet e Ministrisë së Drejtësisë dhe po ashtu vijon situatën e paligjshme prej vitit 2018, pa dhënë asnjë argument apo shkak sipas të cilit mund të vendosej në situatën e parashikuar në gërmën "ç", të nenit 26, të Ligjit nr.110/2018 "Për noterinë".

Sa më sipër, Bordi Disiplinor konkludon që ta konsiderojë shumë të rëndë shkeljen e demonstruar nga ana e noterit Arben Haveri, duke vlerësuar edhe faktin e përsëritjes së shkeljes disiplinore në mënyrë të shkallëzuar, brenda një periudhe të shkurtër kohore nga dhënia e masës së parë disiplinore.

Në këto kushte, Bordi Disiplinor i Dhomës Kombëtare të Noterisë ka vendosur:

- 1. Pranimin e kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj noterit Arben Haveri;*
- 2. Lënien në fuqi të masës së propozuar nga Ministri i Drejtësisë sipas gërmës "dh", të nenit 26, të Ligjit nr.110/2018 "Për noterinë";*
- 3. Heqjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së noterit Arben Haveri.*

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 26, pika 2, gërma “dh”, të nenit 53, pika 2, gërma “b” të ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, si dhe Vendimit të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë nr.2/2021, datë 23.03.2021,

URDHËROJ:

1. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit Arben Haveri, anëtar i Degës Vendore Tiranë, si pasojë e shkeljeve të konstatuara, si dhe Vendimit të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë nr.2/2021, datë 23.03.2021.
2. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a) Znj.Ina Papa, Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - b) Një noter i caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Tiranë;
 - c) Një përfaqësues i caktuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë.
3. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit Arben Haveri, nga Komisioni i caktuar në pikën 2, të këtij Urdhri.
4. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Bankat e nivelit të dytë.
5. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.
6. Dega Vendore e Noterisë Tiranë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, brenda 7 ditëve nga marrja dijeni e këtij Urdhri, të përcjellë emrin e noterit për marrjen në dorëzim të arkivit, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”.
7. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit, pas administrimit të emrit të noterit, sipas pikës 6, të këtij Urdhri, merr masa për dorëzimin me procesverbal të arkivës noterit të përcaktuar nga Dega Vendore përkatëse e Noterisë, brenda 10 ditëve pune.
8. Ndaj këtij urdhri, noteri mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij.

Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.

10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dega Vendore e Noterisë Tiranë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.
11. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij Urdhri noterit Arben Haveri, Dhomës Kombëtare të Noterisë, si dhe Bordit Disiplinor .

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

[Signature]

Etilda Gjonaj (Saliu)

